



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)**  
*Prishtinë*

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE  
PASQYRAT E BURIMEVE DHE PERDORIMEVE  
TË FONDEVE PER PERIUDHEN**

**deri me 31 dhjetor 2023**

---

Prishtinë, 26 shkurt, 2024

## **Përmbajtja**

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	
Identifikimi	1
Pasqyra e pozitës financiare	2
Pasqyra e performancës	3
Pasqyra e rrjedhës së parasë	4
Shënimet e pasqyrave financiare	5-15
SHTOJCAT	16-17

## ***Shkurtesat***

KOK	Komiteti Olimpik i Kosovës
KON (IOC)	Komiteti Olimpik Ndërkombëtar
KOE (EOC)	Komiteti Olimpik i Evropës
KAS	Këshilli i arbitrazhit Sportiv
OJQ	Organizatë jo qeveritare
VIK	Value in kind (vlerë në natyrë)

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për: z. Ismet Krasniqi, Presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës**  
**Bordin e Komitetit Olimpik të Kosovës**

**Prishtina - Kosova**

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Komiteti Olimpik i Kosovës, Prishtinë - Kosovë (KOK), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2023 dhe 2022, pasqyrën e performancës dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Komiteti Olimpik i Kosovës më 31 Dhjetor 2023, si dhe të performancës së saj financiare dhe flukseve të mjeteve monetare për vitin që përfundon në përputhje me politikat kontabël dhe procedurat e shpalosura në Shënimin 2 të pasqyrave financiare shoqëruese.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Legjislacionin përkatës për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim në Kosovë, Ligji Nr. 06/L-043; për Lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare; Ligji NR. 05/L-029; për Tatimin në të Ardhurat në Korporatave, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Tomorr ZHAVELI**  
**Auditor Ligjor**

Prishtina, 26 shkurt, 2024



# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## 1. Identifikimi

### 1.1 Caktimi i Auditimit

## 1. Identifikimi

### 1.1 Caktimi i Auditimit

#### Klienti:

#### **Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK)**

Ismet Krasniqi, President i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK)

Rr. "Agim Ramadani" Nr.253

Shtëpia e Sporteve, Kati III

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383/ 38/ 22 22 23

Fax: +383/ 38/ 22 22 23

Mob: +383/ 44/ 50 17 13

E-mail: [info@noc-kosovo.org](mailto:info@noc-kosovo.org)

Web: [www.noc-kosovo.org](http://www.noc-kosovo.org)

#### Kontraktori:

#### **N.Sh. "Balluku&Zhaveli", Ortakëri e Përgjithshme**

Tomorr Zhaveli, Partner

Agim Ramadani 36/12

10000 Prishtinë; Kosovë

Tel: + 383 44 500 421

E-mail: [tzhaveli@yahoo.com](mailto:tzhaveli@yahoo.com)

#### Detyra:

**Auditimi i pasqyrave financiare të KOK për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023**

### 1.2. Auditori/të e ngarkuar

Tomorr Zhaveli, Auditor Ligjor

### 1.3. Personat kontaktues

KOK:

Ismet Krasniqi, President i Komitetit Olimpik të Kosovës

Endrit Sylja, Udhëheqës i Departamentit Financiar

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## PASQYRA E POZITËS FINANCIARE ME DATËN 31 DHJETOR 2023

(vlerat në Euro)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>PASURITË</b>			
Paraja në bankë dhe arkë	3	2,236,782	254,338
Të arkëtueshmet	4	175,707	179,217
Shpenzimet e parapaguara	5	30,713	168,810
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>2,443,202</b>	<b>602,365</b>
<b>Pasurit e prekshme</b>			
Pajisjet dhe orenditë	6	324,486	51,431
<b>Gjithsej pasurit prekshme</b>		<b>324,486</b>	<b>51,431</b>
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>2,767,688</b>	<b>653,796</b>
<b>DETYRIMET DHE BALANCA E FONDEVE</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogarit e pagueshme	7	62,357	22,746
<b>DETYRIMET TJERA</b>			
Detyrimet tjera ndaj Federatave/Sportistëve		82,250	52,300
Detyrimet për Paga tatime dhe kontribute, kompensime tjera Stafit dhe të tjerëve		16,637	10,881
Detyrimet tjera		1,244	652
Të hyrat e Shtyra		150,000	170,060
Depozita në Banke për LM Prishtina 2030		2,000,000	-
<b>Detyrimet tjera gjithsej</b>	8	<b>2,250,131</b>	<b>233,893</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Detyrimet ndaj Bankave		86,856	-
<b>Gjithsej Detyrimet Afatgjata</b>	9	<b>86,856</b>	-
<b>Gjithsej Detyrimet</b>		<b>2,399,344</b>	<b>256,639</b>
<b>TE HYRAT E SHTYRA / FONDET</b>			
<b>Te hyrat e Shtyra</b>			
Balanca e fondeve - VITI PARAPRAK		397,158	236,555
Balanca e fondeve - VITI AKTUAL		(28,814)	160,603
<b>Balanca e fondeve gjithsej</b>	10	<b>368,344</b>	<b>397,158</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE BALANCA E FONDEVE</b>		<b>2,767,688</b>	<b>653,796</b>

Autorizuar nga Bordi Ekzekutiv me 26.02.2024

Z. Ismet Krasniqi  
President i KOK

Endrit Syla  
Udhëheqës i Departamentit Financiar

 

*Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave*



21

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## PASQYRA E PËRFORMANCËS PËR VITIN QË PËRFUNDON ME 31 DHJETOR 2023

(vlerat në Euro)

Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fondet e pranuar gjatë vitit	2,140,335	1,891,113
Te hyrat e shtyra nga vitet paraprake	170,060	127,807
Te hyrat e shtyra e vitit vijues	(150,000)	(170,060)
11	<b>2,160,395</b>	<b>1,848,860</b>
<b>Shpenzimet</b>		
Aktivitetet e KOK	(1,595,100)	(720,154)
Bursat Olimpikë	(197,571)	(141,225)
Kompensimet për paga dhe kompensimet tjera	(165,819)	(139,173)
Shpenzimet Administrative	(85,042)	(98,805)
Shpërblimet për sportist	(11,000)	(25,500)
Memorandumi MKRS - KOK për financimin e Federatave Sportive	(38,658)	(358,945)
Strategjia Kombëtare në Sport	-	(145,799)
Hartimi i planit strategjik të KOK	-	(16,914)
Hartimi i draft konceptit të Ligjit të sportit	(27,328)	(27,016)
Zhvlerësimi	(68,691)	(14,726)
12	<b>(2,189,209)</b>	<b>(1,688,257)</b>
<b>TEPRICA E FONDEVE MBI SHPENZIMET</b>	<b>(28,814)</b>	<b>160,603</b>

Autorizuar nga Bordi Ekzekutiv me 26.02.2024

Z. Ismet Krasniqi  
President i KOK

Endrit Syla  
Udhëheqës i Departamentit Financiar



Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave

RL

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## PASQYRA E RRJEDHËS SE PARASË PËR VITIN QË PËRFUNDON ME 31 DHJETOR 2023

(vlerat në Euro)

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
<b>AKTIVITETET OPERATIVE</b>		
<b>Neto e hyrat</b>	(28,814)	160,603
<b>Rregullimet për barazim të net të hyrat</b>		
· Zhvlerësimi	68,691	14,726
· Llogaritë e arkëtueshmet	3,510	(57,236)
· Llogaritë e parapaguara	138,097	(115,789)
· Llogaritë e pagueshme	39,611	10,219
· Llogaritë e tjera te pagueshme	2,016,239	72,797
<b>Neto paraja nga aktivitetet operative</b>	<u><b>2,237,334</b></u>	<u><b>85,320</b></u>
<b>AKTIVITETET INVESTIVE</b>		
· Pajisjet dhe makineritë	(341,746)	(32,123)
<b>Neto paraja nga aktivitet Investive</b>	<u><b>(341,746)</b></u>	<u><b>(32,123)</b></u>
<b>AKTIVITETET FINANCUESE</b>		
· Kredit (Lizing)	86,856	(0)
<b>Neto paraja nga aktivitet Financues</b>	<u><b>86,856</b></u>	<u><b>(0)</b></u>
<b>Neto paraja për periudhën</b>	<b>1,982,444</b>	<b>53,197</b>
Paraja në fillim të periudhës	254,338	201,141
<b>PARAJA NË FUND TË PERIUdhËS</b>	<u><b>2,236,782</b></u>	<u><b>254,338</b></u>

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave



# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

---

### 1. TË PERGJITHSHME

Komiteti Olimpik i Kosovës është themeluar në përputhje me vendimin e kryesisë së Bashkimit të Shoqatave të Pavarura të Sporteve të Kosovës të Republikës së Kosovës, më 27 maj 1992, në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur konstituive, në të cilën u themelua institucioni më i lartë sportiv në vend, Komiteti Olimpik i Kosovës.

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) e është regjistruar në Republikën e Kosovës konform Ligjit PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATAT JOQEVERITARE (Ligji Nr. 06/L-043) me numër të regjistrimit të Organizatës. 51105524 më 25.11.2005. KOK Kosovë ka numrin fiskal 600404397.

Prej 09.12.2014 KOK është anëtare i plote i Komitetit Olimpik Ndërkombëtare (IOC), KOK po ashtu është anëtare edhe i organizatave ndërkombëtare si: ANOC, EOC, ICMG, AFCNO, SIGA TAFISA, Peace & Sport, ENGSO, VADA, FICTS.

Anëtarë të KOK janë të gjitha Federatat Sportive të Kosovës anëtare të federatave botërore përkatëse.

**Misioni i KOK-ut** është të zhvillojë, promovojë dhe të mbrojë Lëvizjen Olimpikë në Kosovë, në pajtueshmëri me Kartën Olimpikë.

**Roli i KOK-ut** është:

- Të promovojë parimet fundamentale dhe vlerat e olimpizmit në Kosovë, në veçanti në fushën e sportit dhe edukimit, duke promovuar programe edukative olimpikë në të gjitha nivelet e shkollimit në institucionet dhe universitetet sportive dhe të edukimit fizik, si dhe duke inkurajuar krijimin e institucioneve të orientuara në edukimin olimpik, siç janë: Akademia Olimpikë Kombëtare, Muzeu Olimpik dhe në programet tjera duke përfshirë ato kulturore e që ndërlidhen me Lëvizjen Olimpikë.
- Të siguroj mbikëqyrjen e Kartës Olimpikë në Kosovë. Të inkurajoj zhvillimin e sportit të performancës së lartë, si dhe sportin për të gjithë në Kosovë.
- Të ndihmoj në trajnimin e administratorëve të sportit.
- Të ndërmerr veprime kundër çdo forme të diskriminimit dhe të dhunës në sport.
- Të miratoj dhe zbatoj Kodin Botëror të Anti-Dopingut, duke siguruar se politikat dhe rregullat e KOK-ut për Anti-Doping të anëtarëve dhe/ose kërkesat për fonde, si dhe procedurat e menaxhimit të rezultateve janë në pajtim me Kodin Botëror për Anti-Doping dhe respektojnë të gjitha rolet dhe përgjegjësitë për Komitetet Olimpikë Kombëtare që janë të listuara brenda Kodit Botëror për Anti-Doping.
- Të inkurajoj dhe të mbështesë masat lidhur me kujdesin mjekësor dhe shëndetin e sportistëve.
- Me qëllim të plotësimit të misionit të tij, KOK-u mund të bashkëpunojë me organet qeveritare dhe të punojë në zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve harmonike dhe të dobishme me organet qeveritare, me mirëkuptim reciprok dhe në respektim të juridiksionit dhe të përgjegjësisë së çdo entiteti. Megjithatë, KOK-u nuk do të shoqëroj vetën me asnjë aktivitet që do të ishte në kontradiktë me Kartën Olimpikë. KOK-u, po ashtu mund të bashkëpunoj me organizata jo-qeveritare.

KOK-u ruan autonominë e tij dhe mundohet t'i rezistojë të gjitha presioneve të çdo lloji, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm në presionet politike, ligjore, religjioze ose ekonomike që mund ta parandalojnë nga përshtatja me Kartën Olimpikë.

KOK-u mund të asistoj federatat sportive kombëtare ose asociacionet, të zhvillojnë dhe promovojnë sportin e tyre, si dhe sportistët në Kosovë, në kuadër të kornizës së Kartës Olimpikë dhe rregullave të aplikueshme të Federatave Sportive Ndërkombëtare përkatëse.

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

---

### 2. BAZA E PREZANTIMIT DHE PËRMBLEDHJA E PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

#### 2.1. BAZA E PREZANTIMIT

Pasqyrat financiare janë përgatitur me qëllim të raportimit për aktivitete e KOK në përputhje me objektivat e kësaj KOK, MKRS e për projektet e përfituara dhe të realizuara gjatë periudhës së këtij raporti.

Raporti financiar është përgatitur nga KOK, e cila mban të dhënat kontabël në softwerin e kontabilitetit QuickBooks.

Raportet financiare janë të përgatitura sipas SNRF për NMV.

#### 2.2. PERMBLEDHJA E PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare është paraqitur më poshtë:

##### 2.2.1. Monedha raportuese

Fondet janë marrë në euro, ndërsa shpenzimet janë të qëndrueshme në valutë Euro (monedhe e Kosovës). Raporti financiar është shprehur në Euro, në të cilën është paraqitur në monedhat e përdorura nga KOK në operacionet e saj. Transaksionet në valuta të tjera jo euro janë përkthyer në euro me kursin përkatës të këmbimit në datën e transaksionit.

##### 2.2.2. Tatimet

Në përputhje me aktivitetin që e realizon KOK si OJQ është e liruar nga tatimi mbi fitimin. Pagesat ndaj personelit dhe pagesat ndaj personave fizik ngarkohen me taksë dhe kontributin pensional mbi të ardhurat në bazë të Rregulloreve të aplikueshme në Kosovë.

##### 2.2.3. Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera

Arkëtueshmet janë deklaruar në vlerën neto të realizueshme të tyre.

##### 2.2.4. Detyrimet

Detyrimet paraqesin shumat në lidhje me shpenzimet e njohura në baza akruale. Detyrimet janë paraqitur me vlerën e kostos së tyre. Në 31 Dhjetor 2023, detyrimet e mbetura lidhen me detyrimet e KOK me këtë datë.

##### 2.2.5. Të ardhurat

Fondet e marra janë përfitur nga MKRS, Donatoret e jashtëm si KON, KOE, Solidariteti Olimpik Sponsoruesit e KOK, Kotizimet e Federatave Olimpikë anëtarë të KOK, si të ardhura tjera.

Të ardhurat e pranuar kanë destinime të përcaktuara për realizimin e aktiviteteve programore nga ana e KOK dhe njihen si të ardhura, respektivisht si kërkesa kur ekziston një siguri e arsyeshme se KOK ka respektuar kushtet e kontraktuara.

Të ardhura nga Donacionet dhe të ardhurat tjera janë regjistruar / njohur, kur janë fituar në vend se kur janë pranuar.

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### 3. PARAJA NË BANKË DHE ARKË

Paraja dhe ekuivalentet e parasë me 31 dhjetor 2023 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Pro Credit Bank Prishtina	2,306	225,498
Banka BKT	234,476	28,840
	<u>236,782</u>	<u>254,338</u>
Depozitat në BKT	2,000,000	-
	<u>2,236,782</u>	<u>254,338</u>

Depozitat e pranuar nga MKRS në emër të pagesës dhe sigurimit të kuotës së organizimit të Lojërave Mediterane Prishtina 2030 në vlerë prej 2,500.000.00 Euro, të pranuar me dt. 02.11.2023 sipas Memorandumit për realizimin e pagesave për Lojërat mesdhetare nr.49151/2023 dt. 19.09.2023, si garanci bankare e cila depozitohet në një bankë komerciale deri në pagesën e kështit të fundit dt.31 maj 2030. Nga kjo shumë, me datën 03.11.2023 është paguar kështi i parë një vlerë prej 500.000.00 Euro. Shuma e mbetur trajtohet si e hyra të shtyra gjatë tërë periudhës deri në pagesën totale ndaj International Committee of the Mediterranean Games (ICMG).

### 4. TË ARKËTUESHMET

Më 31 dhjetor 2023 të arkëtueshmet janë të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Huazimet e dhëna Federatave	55,290	49,298
Kotizimet	16,100	8,800
Marketing	17,926	66,466
Të arkëtueshmet tjera për Projekte	15,708	38,889
Të arkëtueshmet tjera	70,683	15,764
	<u>175,707</u>	<u>179,217</u>

### 5. SHPENZIMET E PARAPAGUARA

Balanca e shpenzimeve të parapaguara me 31 dhjetor 2023 janë të prezantuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
YOG Gangwon 2024	11,175	-
Parapagim për akomodim - LO Paris 2024	17,810	-
EYOF FVG 2023 - Uniforma e ekipit Olimpik	-	16,664
EYOF FVG 2023 - Akomodim	-	23,360
Parapagimet për Pajisje të KOK	-	65,995
Parapagimet renovimet për objektet në shfrytëzim	-	61,062
Tjera	978	979
LO Tokyo 2020 - Federata e Boksit Përgatitjet	750	750
	<u>30,713</u>	<u>168,810</u>

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### 6. PASURIT JOQARKULLUESE

	Pajisjet	Mobilet	Makinat	Investimet në objektet në shfrytëzim	Gjithsej
<b>Kostoja</b>					
Me 01 janar 2023	55,841	8,106	28,729	11,040	103,716
Shtesat gjatë vitit	24,796	43,688	192,790	80,473	341,747
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>80,637</b>	<b>51,794</b>	<b>221,519</b>	<b>91,513</b>	<b>445,463</b>
<b>Zhvierësimi i akumuluar</b>					
Me 01 janar 2023	(16,938)	(7,070)	(17,237)	(11,040)	(52,285)
Shtesat gjatë vitit	(3,551)	(12,212)	(28,095)	(24,832)	(68,691)
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>(20,489)</b>	<b>(19,282)</b>	<b>(45,332)</b>	<b>(35,872)</b>	<b>(120,975)</b>
<b>Vlera neto</b>					
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>60,149</b>	<b>32,512</b>	<b>176,187</b>	<b>55,641</b>	<b>324,488</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>38,904</b>	<b>1,036</b>	<b>11,492</b>	-	<b>51,431</b>

### 7. LLOGARIT E PAGUESHME

Më 31 dhjetor 2023, llogarit e pagueshme janë të detajuara si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Llogarit e pagueshme	62,375	22,746
	<b>62,375</b>	<b>22,746</b>
	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Loughborough University Enterprises Limited	-	8,250
Organizing Committee EYOF FVG 2023	-	6,900
Hotel Sirius	13,620	2,683
Globus Travel Sh.p.k	-	1,095
Living L.L.C	9,161	1,062
ENGSO	1,500	-
Sports Law and Policy Center	4,600	-
Organisation internationale la Francophonie	4,400	-
Libraria Dukagjini	2,490	-
Seibersdorf Laboratories	2,385	-
Vlera N.T.P	1,662	-
Tjera	22,537	2,756
	<b>62,357</b>	<b>22,746</b>

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### 8. DETYRIMET TJERA

Më 31 dhjetor 2023, detyrimet tjera janë të detajuara si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Detyrimet tjera ndaj Federatave/sportistëve	82,250	52,300
Detyrimet për Paga tatime dhe kontribute kompensime tjera	-	10,394
Stafi dhe të tjerëve	1,364	1,139
Detyrimet tjera	150,000	170,060
Të hyrat e shtyra - për projektet në vazhdimësi	2,000,000	-
Të hyrat e shtyra - Depozita për LM 2030 *	<b>233,614</b>	<b>233,893</b>

- Referoju Shënimit nr.3

### 9. Detyrimet afatgjata

Më 31 dhjetor 2023, detyrimet afatgjata janë Detyrimet ndaj Bankës BKT për blerjet e automjeteve me Lizing dhe janë detajuara si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Detyrimet ndaj Bankave	86,856	-
	<b>86,856</b>	-

### 10. FONDET

Fondet e KOK me gjendjen e datës 31 dhjetor 2023 janë të detajuara si më poshtë:

	<b>Euro</b>
<b>Balanca e fondeve me 31.12.2020</b>	<b>204,866</b>
<b>Viti 2021</b>	
Fondet e pranuar gjatë vitit 2021	912,466
Fondet e shpenzuara/realizuara gjatë vitit 2021	(880,778)
<b>TEPRICA E FONDEVE MBI SHPENZIMET PER VITIN</b>	<b>31,689</b>
<b>Balanca e fondeve me 31.12.2021</b>	<b>236,555</b>
<b>Viti 2022</b>	
Fondet e pranuar gjatë vitit 2022	1,848,860
Fondet e shpenzuara/realizuara gjatë vitit 2022	(1,688,257)
<b>TEPRICA E FONDEVE MBI SHPENZIMET PER VITIN</b>	<b>160,603</b>
<b>Balanca e fondeve me 31.12.2022</b>	<b>397,158</b>
<b>Viti 2023</b>	
Fondet e pranuar gjatë vitit 2023	2,160,395
Fondet e shpenzuara/realizuara gjatë vitit 2023	(2,189,209)
<b>TEPRICA E FONDEVE MBI SHPENZIMET PER VITIN</b>	<b>(28,814)</b>
<b>Balanca e fondeve me 31.12.2023</b>	<b>368,344</b>

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### 11. TË HYRAT E KOK / FONDET E PRANUARA

Tabela në vijim jep një përmbledhje të fondeve të transferuara për projekte dhe të hyrat tjera të KOK sipas Donatorit dhe projektit gjatë vitit 2023 dhe 2022.

	<b>Projekti</b>	<b>v.2023</b>
EOC	European Olympic Committee	117,601
EOC	EOC	7,614
	<b>EOC Gjithsej</b>	<b>125,215</b>
IOC	Campaign for the awareness of the sports community in Kosovo for safeguarding	9,865
IOC	Kursi per trajner të ping pongut	5,123
IOC	Bursat IOC Paris 2024	54,005
IOC	Renovation of NOC Kosovo offices	59,940
IOC	Sport Development 2021-2024	16,502
IOC	Team Support Grant Handball 2021 - 2024	22,173
IOC	Të hyrat nga IOC dhe EOC:International Olympic Committee	1,413
IOC	Të hyrat nga IOC dhe EOC	1,963
IOC	Youth athlete development- YOG Qualification	20,399
IOC	IOC,SO: Administrative Subsidy 2023	41,072
IOC	Top Partner Program 2023	30,729
IOC	Olympic Day 2023	4,512
IOC	ASMC4	9,385
IOC	Together for wellbeing	2,886
IOC	Technical Course for Coaches, Basketball 2023	6,590
IOC	Technical Course for Coaches, Tennis 2023	5,923
IOC	ASMC3 Balance Payment	3,059
IOC	Të hyra Tjera	3,164
	Te hyrat nga padit në KAS	8,000
	Te hyrat nga ENGSO	10,137
	<b>IOC Gjithsej</b>	<b>316,840</b>
	<b>Kotizimet nga Federatat</b>	
	Kotizimet nga Federatat	10,600
	<b>Kotizimet Gjithsej</b>	<b>10,600</b>
	<b>MKRS</b>	
	61601 Memorandumi MKRS-KOK 2023	800,000
	61001 Te hyrat nga MKRS për LM Prishtina 2030	500,000
	61505 Memorandumi MKRS - KOK për ndihme federatave sportive	38,658
	61605 Memorandumi MKRS-KOK, Zyra e KAS	50,000
	61600 Te hyrat nga MKRS 2023	12,500
	61606 Memorandumi MKRS-KOK, Promovimi i LM Prishtina 2030	91,546
	<b>MKRS Gjithsej</b>	<b>1,492,704</b>

81

## KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

---

<b>Projekti (Vazhdim)</b>	
<b>Sponsorizimi</b>	
Olive Medical Group	25,000
Hotel Sirius-Sponsorizimi	6,829
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.	125,000
Sponsorizimi Burger King (Ballkan Foods)	18,630
Sponsorizimi Prime Tours Travel shpk	7,500
<b>Sponsorizimi Gjithsej</b>	<b>182,959</b>
<b>Sponsorizimi-Shërbim (VIK)</b>	
Olive Medical Group	5,067
OTCSF 4 F	11,906
<b>Sponsorizimi-Shërbim (VIK) Gjithsej</b>	<b>16,973</b>
<b>Sponsorizimi-Shërbim (VIK) Gjithsej</b>	<b>199,932</b>
<b>Tjera</b>	
Te hyrat Tjera	15,104
<b>Tjera Gjithsej</b>	<b>15,104</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>2,160,395</b>

82

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

<b>Projekti</b>	<b>v.2022</b>
<b>EOC</b> EOC:OG Qualification System	19,686
<b>IOC</b> EOC:EOC Grant 2022-2023	116,172
<b>EOC Gjithsej</b>	<b>135,858</b>
<b>IOC</b> IOC,SO: 2022 Kursi teknik per trajner Federata e Shigjetarise 3-8.5.2022	6,065
<b>IOC</b> IOC,SO: 2022 Kursi mundjes per trajner 19-23.01.2022	3,824
<b>IOC</b> IOC,SO: 2022 Kursi për trajnimin e trajnereve te shenjetarise 21- 24.04.22	6,470
<b>IOC</b> IOC,SO: 2022 Regional Forum for Europe - Games Preparation	730
<b>IOC</b> IOC,SO: Administrative Subsidy 2022	40,870
<b>IOC</b> IOC,SO: ASMC3	9,103
<b>IOC</b> IOC,SO: Beijing 2022	6,851
<b>IOC</b> IOC,SO: Bursat IOC Paris 2024	83,700
<b>IOC</b> IOC,SO: Bursat Olimpik Pekin 2022	10,404
<b>IOC</b> IOC,SO: International Day of Sport for Development 2022	4,393
<b>IOC</b> IOC,SO: NOC Games Operations - 2021	8
<b>IOC</b> IOC,SO: NOC Games Operations - Beijing 2022	617
<b>IOC</b> IOC,SO: Olympic academy 2021 - 2022	21,100
<b>IOC</b> IOC,SO: Olympic Academy 2022-2023	21,044
<b>IOC</b> IOC,SO: Olympic Day 2022	4,690
<b>IOC</b> IOC,SO: Participation on games Beijing 2022	4,665
<b>IOC</b> IOC,SO: Reimbursement of Flight ticket Beijing 2022	14,386
<b>IOC</b> IOC,SO: Sport Development 2021-2024	23,284
<b>IOC</b> IOC,SO: Team Support Grant Handball 2021 - 2024	23,087
<b>IOC</b> IOC,SO: Technical Course for Coaches Volleyball 2022	4,698
<b>IOC</b> IOC,SO: Technical Course for Coaches, Basketball 2022	6,629
<b>IOC</b> IOC,SO: Top Partner Program 2022	32,536
<b>IOC</b> IOC,SO: Translation of Manuals 2022	4,322
<b>IOC</b> ICMG	2,132
<b>Tjera</b> Të hyra tjera	4,570
<b>IOC Gjithsej</b>	<b>340,176</b>
<b>Kotizimet nga Federatat</b>	
Kotizimet nga Federatat	10,200
<b>Kotizimet Gjithsej</b>	<b>10,200</b>
<b>MKRS</b>	
Memorandumet MKRS - KOK 2022	680,000
Memorandumet MKRS - KOK 2022, për ndihme federatave sportive	358,945
Memorandumet MKRS - KOK 2022, zyrja e KAS 2022-2023	15,000
Memorandumet MKRS - KOK 2022, KosAda 2022	12,500
Memorandumet MKRS - KOK 2021, Aneks Memorandumi Pekin 2022	36,925
Memorandumet MKRS - KOK 2021, Pako e ringjalljes Ekonomike 2021	65,561
<b>MKRS Gjithsej</b>	<b>1,168,931</b>



# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### Projekti (Vazhdim)

#### Sponsorizimi

BKT	25,000
Olive Medical Group	25,000
Selmans sponsorizimi	1,364
Sponsorizimi Hotel Sirius	6,830
Burger King (Ballkan Foods)	1,370

---

**Sponsorizimi Gjithsej** **59,563**

#### Sponsorimi- Shërbim (VIK)

Fourteen	78,972
Kosovapress	6,300
Olive Medical Group	25,000
Toyota	21,360

---

**Sponsorimi- Shërbim (VIK) Gjithsej** **131,632**

---

**Sponsorimi Gjithsej** **191,195**

#### Tjera

Te hyrat nga ankesat në KAS	2,500
-----------------------------	-------

---

**Tjera Gjithsej** **2,500**

---

**Gjithsej** **1,848,860**

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### 12. SHPENZIMET

Shpenzimet për vitin 2023 dhe 2022 më sipas aktiviteteve përbëhen si më poshtë:

	2023	2022
<b>Aktivitetet e KOK</b>		
Shpenzime të udhëtimit dhe akomodimit të KOK dhe Ekipit Olimpik	262,486	179,920
Shpenzimet për pjesëmarrje në gara të ekipit Olimpik	240,810	122,656
Komisione dhe grupe punuese	6,468	11,448
Mëditje të bordit dhe stafit për udhëtime zyrtare	102,247	82,416
Mbështetja e ekipeve për përgatitje	9,231	3,000
Shpenzimet për bursat Pekin 2022	-	10,404
Sigurime të veturave zyrtare	10,894	1,568
Shpenzimet për kontrollet mjekësore/analiza të Ekipit Olimpik	5,067	25,000
Shpenzimet për uniforma për ekipin Olimpik (VIK)	11,906	78,972
Shpenzimet e KAS	37,902	6,511
Kotizimet ndërkombëtare	2,259	2,290
Përgatitjet për Sportistët Elitar LO Beijing 2022	-	772
Shpenzime për organizimin e mbledhjes së BE të ICMG-Prishtine	5,875	47,903
Pajisje dhe uniforma sportive për pjesëmarrje në Lojëra	41,095	20,701
Shpenzimet për përcjelljen mediatike të ngjarjeve	-	6,300
Shpenzimet e hulumtimit të opinionit publik	-	8,260
Team Support Grant Hendboll 2021-2024	22,173	23,087
Kurset për trajnimin e trajnerëve me Federatat Kombëtare	18,753	33,419
Përgatitjet për Sportistët Elitar për EYOF Vuokati 2022	-	3,600
Përgatitje për LM Oran 2022 - Federata	-	15,069
Shpenzimet e zyrës së KosADA	48,631	22,864
Shpenzimet për mëditje të Sportistëve në gara ndërkombëtare	-	10,109
Përgatitjet për EYOF Banska Bistrica 2022	-	2,706
Shpenzimet për mirëmbajtjen e makinave të KOK	6,634	-
Hartimi i Biding book për LM Prishtina 2030	149,950	-
Përgatitjet sportive për EYOF Maribor 2023	5,285	-
Përgatitjet sportive për LE Krakow 2023	8,388	-
Përgatitjet sportive për Paris 202	41,068	-
Shpenzimet e interesit bankar	4,260	-
Shpenzimet e KAS ndërkombëtar për Federatat Sportive	19,600	-
Shpenzimet për bursa për trajner	28,080	-
Shpenzimet për kuotën e organizimit LM Prishtina 2030	500,000	-
Shpenzimet tjera	6,038	1,179
<b>Aktivitetet e KOK</b>	<b>1,595,100</b>	<b>720,154</b>
<b>Bursat Olimpikë</b>		
Bursat Olimpikë	197,571	141,225
<b>Bursat Olimpikë</b>	<b>197,571</b>	<b>141,225</b>
<b>Kompensimet për paga dhe kompensimet tjera</b>		
Kompensimet për paga dhe kompensimet tjera	165,819	139,173
<b>Kompensimet për paga dhe kompensimet tjera</b>	<b>165,819</b>	<b>139,173</b>

24

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

### SHPENZIMET (Vazhdim)

<b>Shpenzimet Administrative</b>		
Shpenzimet per provizione Bankare	4,197	2,728
Shp. për BE- pjesëmarrja në takime	20,691	31,712
Telekomunikim	197	427
Shpenzime për Zyre	44,918	24,717
Shpenzimet e marketingut dhe reklamave	801	1,640
Karburanteve	7,721	5,544
Shpenzimet e parkingut te veturës zyrtare	2,055	660
Shpenzime për Trajnime te Stafit	1,579	5,250
Auditimi	2,360	2,360
Shpenzimet tjera -Makina / Sponsor		21,360
Shpenzimet Administrative	523	2,407
Zhvlerësimi	68,691	14,726
<b>Shpenzimet Administrative</b>	<b>153,733</b>	<b>113,531</b>
<b>Shpërblimet për sportist</b>		
Shpërblimet për sportist për arritjet Sportive	11,000	25,500
<b>Shpërblimet për sportist</b>	<b>11,000</b>	<b>25,500</b>
Shpenzimet për strategjinë kombëtare në Sport	-	145,799
Memorandumi MKRS - KOK Financimi i Federatave Sportive	38,658	358,945
Hartimi i draft konceptit te Ligjit te sportit	27,328	27,016
Hartimi i planit strategjik te KOK		16,914
<b>Gjithsej</b>	<b>2,189,209</b>	<b>1,688,256</b>

- Presidentit i Komiteti Olimpik të Kosovës, z. Ismet Krasniqi, nga muaji kur ka pranuar funksionin, aktivitetin e tije si President e ka kryer në baza vullnetare pa asnjë kompensim në emër të pagës.

84

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

---

### SHTOJCA 1

#### 1. Kontrata për sponsorizim me "OLIVE MEDICAL GROUP"

KOK ka një Marrëveshje për sponsorizim me "OLIVE MEDICAL GROUP", e nënshkruar me datë 12.07.2021.

Me këtë marrëveshje "OLIVE MEDICAL GROUP" do të sponsorizoj përfituesin e sponsorizimit Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK ose Përfituesi) me qëllim të përfitimit të disa të drejtave dhe mundësive për sa i përket produkteve nga programi i Marketingut të KOK e i cili ndërlidhet me partneret e biznesit të KOK, dhe të cilëve, iu jepen disa të drejta dhe mundësi në lidhje me përdorimin dhe respektimin e Markave të KOK në përputhje me qëllimin dhe reputacionin dhe imazhin e Lëvizjes Olimpikë.

Kontrata origjinale mbulon periudhën prej 12 korrik 2021 deri me 31.12.2024, por me kërkesën e sponsorit, kjo marrëveshje shkëput me datën 31.12.2023, për arsye të mos-mundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale, për vitin 2024.

Vlera e tërësishme e sponsorizimit sipas kësaj kontrate është 50,000.00 Euro nga e cila vlera prej 25.000 euro është në vlerë investive e cila transferohet në llogarinë e KOK në transfere mujore prej 2,083 Euro ndërsa 25.000,00 Euro e kalkuluar në shërbime (VIK), nga spektri i shërbimeve të cilat i ofron "OLIVE MEDICAL GROUP" si sponsor.

MKRS përmes Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për lëshimin e vërtetimit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ka lëshuar Vërtetimin nr. 4128/2021/05 dt. 02 dhjetor 2021 me të cilin vërtetohet se sponsorizimi ka për qëllim: zhvillimin e aktiviteteve të KOK në zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive të parapara me kontratë e të cilat paraqesin interes të përgjithshëm për avancimin e sportit.

Përfituesi KOK gjatë vitit 2023, respektivisht nga data 01 janar 2023 (viti i tret raportues), ka realizuar të gjitha detyrimet e parapara me Kontratën në fjalë, dhe shtojcat e kësaj kontratës, për çka ka raportuar Sponsorin OLIVE MEDICAL GROUP, përmes raporteve tremujore mbi realizimin e objektivave/detyrimeve të KOK sipas kontratës për periudhën 01 janar 2023 deri me 31 dhjetor 2023.

22

# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS (KOK)

## Shënimet në Pasqyrën e Burimeve dhe përdorimeve të fondeve për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

---

### 2. Kontrata për sponsorizim me BANKA TREGETARE KOMBETARE Sh.A

KOK ka një kontratë për sponsorizim me BANKA TREGETARE KOMBETARE Sh.A (BKT ose Banka) si sponsor Premium i KOK, e nënshkruar me datë 28.09.2022.

Me këtë kontratë Banka do të sponsorizoj përfituesin e sponsorizimit Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK ose Përfituesi) në aktivitetet e tija për periudhë 2 (dy) vjeçare me efekt prej datës 01 tetor 2022 deri me 30 shtator 2024.

Detyrimet e Përfituesit të sponsorizimit janë definuar në nenin 2 të Kontratës.

Vlera e tërësishme e sponsorizimit sipas kësaj kontrate është 200,000.00 Euro.

Pagesat vjetore prej 100,000.00 Euro realizohen në fillim të çdo vitit përgjatë periudhës kontraktuese.

Transferi për vitin e parë të kontratës me vlerë 100,000.00 Euro është realizuar me datën 07 nëntor 2022.

MKRS përmes Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për lëshimin e vërtetimit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinis dhe sportit, ka lëshuar Vërtetimin nr. 745/2022 dt. 12.dhjetor 2022 me të cilin vërtetohet se sponsori ka për qëllim zhvillimin e aktiviteteve të KOK në zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve sportive të parapara me kontratë e të cilat paraqesin interes të përgjithshëm për avancimin e sportit.

Përfituesi KOK gjatë vitit 2022, respektivisht nga data 01 tetor 2022, data e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, ka realizuar të gjitha detyrimet e parapara Kontraktuale, për çka ka raportuar Sponsorin Bankën BKT, përmes raporteve mbi realizimin e objektivave/detyrimeve të KOK bazuar në kontratë për periudhën nga fillimi i kontratës 01 tetor 2022 deri me 31 dhjetor 2022.